



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	740/20
Nr. i sq. / Br. sh	
Data: / Datum	08.09.2020
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Task- forca në kushte pandemie COVID-19

Bazuar në Udhëzuesit të MASH-it për organizimin e mësimi në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID-19, Task-forca e Komunës së Vushtrrisë për veprim në kushte të kësaj pandemie në takimin e mbajtur më 07.09.2020 merr këtë:


V E N D I M

1. Aprovohet Protokolli për rregullat për hapjen e shkollave në Komunën e Vushtrrisë për vitin shkollor 2020/2021.
2. Aprovohet Plani për zhvillimin e mësimi në kushte pandemie për vitin shkollor 2020/2021.
3. Vlerësohet se Drejtoria për Arsim i ka kryer të gjitha përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor me datën 14 shtator 2020.
4. Protokolli për rregullat për hapjen e shkollave, Plani për zhvillimin e mësimi në kushte pandemie dhe vendimet që merren në takimet që i mban task-forca, të publikim në faqen zyrtare të komunës.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës –
Kryesues i Task-forcës

Vendimi iu dërgohet:

- Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
- Ministrisë së Shëndetësisë
- Zyrës për informim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Udhëzuesit të MASH-it për organizimin e mësimi në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID-19, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E TASK-FORËS NË KUSHTET E PANDEMISË COVID-19 NË
KOMUNËN E VUSHTRRISE

1. Themelohet task-forca komunale për përcjellën e organizimit të mësimi në kushtet e pandemisë COVID-19 në arsimin fillor dhe të mesëm në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 **z. Xhafer Tahiri**, Kryetar i Komunës – kryesues,
 - 1.2 **z. Afrim Namani**, Drejtor i DKA, - zëv.kryesues
 - 1.3 **z. Lutfi Gërguri**, Drejtor BF, - anëtar
 - 1.4 **z. Sylejman Mehulli**, Drejtor i SHPS, - anëtar
 - 1.5 **znj. Violeta Pllana**, Përgjegjëse e shërbimit social në QPS, - anëtare
 - 1.6 **z. Bujar Pllana**, Inspektor Sanitar,
2. Mbledhjet e Task-forcës i udhëheqë Kryetari i Komunës në cilësi të kryesuesit të mbledhjes.
3. Vendimet që merren në mbledhjet e task-forcës i nënshkruan kryesuesi i asaj mbledhje.
4. Task-forca do të bëjë verifikimin e skenarëve me nivelin e rrezikshmërisë në Komunë dhe kushtet e shkollës.
5. Do të bëjë monitorimin e zbatimit të skenarëve në vitin e ri shkollor si dhe bëjë përcaktimin e masave përkrahëse për shkollat në territorin e Komunës.

6. Task-forca do të përpiloj një plan ë punës në të cilin do të përfshihen mbledhjet e rregullta dhe mbledhjet që do të mund të mbahen varësisht prej nevojës, formati i atyre mbledhjeve (sipas nevojës mund të ftohen edhe pjesëmarrës tjerë), mënyra e vendimmarrjes.
7. Task-forca, për punën dhe vendimet që do të i merr i raporton organeve përgjegjëse sipas ligjit.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri



Kryetar i Komunës



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të task-forcës
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	801/20
Nr. i fq. / Br. sf	
Data: / Datum	30.09.2020
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës: nr. 20-SHV01-002-130 datë 22.09.2020 në shumë prej 418.50 € (katërqindetëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë cent), për shpenzime të krijuara në Restorant "Amazona" në Milloshevë – drekë pune e Kryetarit me stafin udhëheqës të komunës.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë